



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr.IBr./No. 1390/2017
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg. 13/09/17
Data/Datum/Date: 13/09/17



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Ex officio

Rasti nr. 594/2017

RAPORT ME REKOMANDIME

I

AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në lidhje me

*Mbrojtjen efektive në procedurë penale dhe garantimin e barazisë së palëve –
caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike*

Drejtuar :

- Z. Nehat Idrizi, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- Z. Enver Peci, Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës
- Z. Blerim Isufaj , Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës
- Z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit
- Z. Besim Morina, U.D. Drejtor i Akademisë së Drejtësisë

Kopje:

- Z. Abelard Tahiri, Ministër
- Ministria e Drejtësisë

Prishtinë, 19 shtator 2017

I. Qëllimi i Raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është térheqja e vërejtjes mbi shkeljen e një prej të drejtave themelore në procedurën penale, të drejtës për mbrojtje efektive në çështjet penale. Në ketë drejtim, do të trajtohet në veçanti garantimi i kësaj të drejte pa pagesë nga ana e shtetit për personat e pandehur, si mënyrë e ruajtjes së interesit të drejtësisë dhe garantimit të barazisë së palëve si parim themelor në procedurë penale.
2. Në zbatim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, Avokati i Popullit përmes këtij raporti ka për qëllim të trajtojë bazën ligjore në lidhje me të drejtën e të pandehurve në procedurë penale që të kenë avokat mbrojtës, duke u fokusuar edhe në të drejtën e caktimit të mbrojtësit pa pagesë (me shpenzime publike) në raste kur i pandehuri nuk ka mundësi financiare. Për këtë qëllim, do të analizohet baza ligjore e brendshme dhe standartet ndërkombëtare si burim i obligimit për organet shtetërore që të garantojnë zbatimin efikas të kësaj të drejte.
3. Avokati i Popullit, që në fillim thekson se barazia e palëve si parim themelor i procedurës penale bashkëkohore është pjesë integrale e gjykimit të drejtë, si e drejtë që përcaktohet edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ). Andaj, e drejta për të pasur avokat mbrojtës në procedurë penale do të analizohet në rend të parë në fryshtë e KEDNJ dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) si burime primare sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Gjithashtu, e drejta në mbrojtje përveç si kategori kushtetuese, rregullohet më konkretisht edhe me legjislacionin tjetër, në rend të parë me Kodin e Procedurës Penale (në tekstin e mëtejmë: KPP).
4. Duke u bazuar në problemet që aktualisht ekzistojnë në sistemin e drejtësisë në Kosovë, në lidhje me garantimin e të drejtës për mbrojtje efektive në çështjet penale, dhe duke e konsideruar këtë si të drejtë themelore dhe parakusht të barazisë së palëve në procedurë penale, Avokati i Popullit përmes këtij raporti, ka si qëllim kryesor:
 - të analizojë problemet dhe sfidat aktuale në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë në lidhje me mos garantimin e të drejtës për mbrojtje efektive, përkatësisht garantimin e mbrojtësit pa pagesë për të pandehurit;
 - të analizojë detyrimet e institucioneve të drejtësisë (në veçanti gjykatës) që burojnë nga Kushtetuta, KPP dhe legjislacioni tjetër në fuqi për të garantuar të drejtën në mbrojtje efektive në procedurë penale, duke interpretuar me saktësi dispozitat ligjore në fuqi.
 - të rikujtojë detyrimet për organet e drejtësisë që dalin nga aktet ndërkombëtare në raport me garantimin e të drejtës për mbrojtje efektive në çështjen penale, në veçanti nga KEDNJ dhe vendimet e GJEDNJ në lidhje me ketë të drejtë.

- në bazë të konstatimeve të arritura të jap rekomandime konkrete si zgjidhje për të ardhmen, në pajtim me autorizimet kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit.

II. Baza juridike

5. Raporti bazohet në nenin 132, parag.1-3 të Kushtetutës, ku përcaktohet se:

1. *Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*
2. *Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës.*
3. *Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj.*

dhe nenin 135, parag.3 ku përcaktohet se:

- *Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”.*

Gjithashtu, ky raport bazohet edhe në Ligjin Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, përkatësisht nenin 16 ku përcaktohet se:

- *Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut” (parag.4);*
- *Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përvèç rastit kur ka zvarritje të procedurave.” (parag.8);*

dhe nenin 18, parag.1 ku përcaktohet se Avokati i Popullit ka edhe këto përgjegjësi:

- *të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre” (nënpag. 1);*
- *të tèrheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë” (nënpag.2);*

- *“të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (pika 4);*
- *“të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (nënparag. 5);*
- *“t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (nënparag. 6).*

III. Përbledhja e fakteve dhe arsyet e hartimit të raportit nga Avokati i Popullit

6. Avokati i Popullit, në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, i ka kushtuar një kujdes të veçantë edhe të drejtave të personave të pandehur në procedurë penale, si pjesë integrale e të drejtave të njeriut në përgjithësi. Për shkak të pozitës specifike që kanë personat që janë në cilësi të të pandehurit në procedurës penale, respektimi i të drejtave të tyre, ka qenë objekt i monitorimit të vazhdueshëm, hulumtimit dhe dhënies së rekomandimeve konkrete për sistemin e drejtësisë penale.¹
7. Një nga sfidat e sistemit të drejtësisë penale në Kosovë mbetet edhe garantimi i të drejtës që i pandehuri si subjekt i procedurës penale të ketë avokat mbrojtës, dhe në rastet kur është e nevojshme, mbrojtësi të caktohet me shpenzime publike. Problemet në lidhje me mos zbatimin e kësaj të drejte, dalin nga të gjeturat e hulumtimeve dhe monitorimeve të ndryshme.
8. Konkretisht, në lidhje me mos respektimin e të drejtës përfaqësim të të pandehurve me avokat mbrojtës në çështjet penale, Avokati i Popullit është njoftuar edhe nga hulumtimi i Institutit të Kosovës për Drejtësi (në tekstin e mëtejmë: IKD) i realizuar në vitin 2017. IKD ka monitoruar seancat gjyqësore në rastet penale në divizionin penal të departamenteve të përgjithshme në Gjykatat Themelore në Prishtinë, Pejë dhe Prizren. Ky monitorim është bërë nga data 1 shkurt deri me 31 maj 2017, në lidhje me mungesën e përfaqësimit të të pandehurve me avokat mbrojtës, ku janë monitoruar 524 seanca gjyqësore në çështjet penale.
9. Avokati i Popullit, vëren se të njëtin problem e tregon edhe rapporti i OSBE-së i publikuar në vitin 2016. Sipas këtij rapporti, nga 216 raste të shqyrtimeve fillestare (ku mbrojtja nuk ka qenë e detyruar) të monitoruara në departamentet e përgjithshme gjatë periudhës janar 2014 - qershori 2015, vetëm 11 raste është caktuar mbrojtësi, 137 raste të pandehurit nuk kanë pasur mbrojtës, dhe në 68 raste të tjera, avokati mbrojtës është caktuar nga vetë të pandehurit. Gjithashtu, edhe në shqyrimet fillestare në departamentet e krimeve të rënda, nga 96 raste të monitoruara (ku mbrojtja nuk ka qenë e detyruar), vetëm në 8 raste është caktuar mbrojtësi me shpenzime publike, ndërsa në 70 raste të pandehurit nuk kanë pasur avokat mbrojtës, dhe në 18 raste të tjera avokati është

¹ Shih në veçanti edhe reportin me titull: “Të drejtat e të pandehurit në procedurë penale – fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës” të publikuar me 20 tetor 2016 (http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/1077-2016_Raport_me_rekomandime_445741.pdf).

angazhuar nga të pandehurit me shpenzimet e tyre.²

10. Mbi bazën e këtyre fakteve, dhe informatave të tjera të siguruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshmë: IAP) në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij, Avokati i Popullit, në vijim të raportit do të trajtojë të drejtën e të pandehurit për të pasur avokat mbrojtës, dhe në rastet kur i pandehuri nuk ka mjete për mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes, avokati të caktohet pa pagesë (me shpenzime publike).

IV. Mbrojtja efektive në çështjet penale si e drejtë themelore për të pandehurin

11. Duke u nisur nga vetë pozita e personit të pandehur në procedurë penale, i cili përballet me dyshimin e kryerjes së veprës penale, dhe mundësinë e shqiptimit të sanksioneve penale, e bën të domosdoshme nevojën e respektimit rigoroz të të drejtave dhe garancive procedurale ndaj tij. Në ketë drejtim, ka rëndësi të posaçme që i pandehuri të jetë i barabartë me prokurorin e shtetit i cili përfaqëson organin e akuzës, që shprehet me parimin e barazisë së palëve në procedurë penale.
12. Avokati i Popullit, që në fillim thekson se barazia e palëve si parim themelor në procedurë penale, është pjesë integrale e gjykimit të drejtë siç përcaktohet në nenin 6 të KEDNJ. Mbi ketë bazë, mbrojtja efektive në çështjet penale duhet të garantohet si parakusht i respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, përkatësisht personit të pandehur, që ndaj tij të ketë një proces gjyqësor të drejtë.
13. Avokati i Popullit rikujton, se barazia e palëve në procedurë penale nënkupton në rend të parë një barazi nga aspekti profesional ndërmjet të pandehurit dhe prokurorit të shtetit. Në ketë drejtim, duke u nisur nga fakti se të pandehurit në shumicën e rasteve janë laik (pa përgatitje juridike) dhe në anën tjetër kanë një ngarkesë të veçantë emocionale për shkak të pozitës procedurale, një barazi e tillë profesionale mund të vij në shprehje vetëm nëse i pandehuri përfaqësohet nga avokati.
14. Barazia e të pandehurit me prokurorin e shtetit nga aspekti profesional është premisë e barazisë efektive procedurale, në kuptim të një sigurie se i pandehuri nuk do të dëmtohet për shkak të mosnjohjes se të drejtave të tij në procedurë penale. Angazhimi i avokatit paraqet garanci se të pandehurit nuk do ti cenohet dinjiteti njerëzor, do të prezumohet i pafajshëm dhe do ti shfrytëzoj në mënyrë efikase të gjitha mjetet ligjore për mbrojtje nga akuzat, dhe në fund të procesit penale ndaj tij të ketë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, siç garantohet me ligj, kushtetutë dhe me instrumentet ndërkombëtare.
15. Për me tepër, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se e drejta e të pandehurit që të ketë mbrojtës në procedurë penale është e karakterit absolut, dhe si e tillë, paraqet obligim për shtetin që të siguroj avokatin mbrojtës në të gjitha rastet kur i pandehuri nuk ka mundësi financiare që të paguaj vetë shpenzimet e mbrojtjes.
16. Ky karakter i të drejtës për mbrojtje profesionale nga avokati, derivon nga aktet ndërkombëtare, kushtetua dhe legjislacioni penal i Republikës së Kosovës.

² Me shumë shih Raporti i OSBE-së: Shqyrtimi i zbatimit të kodit të ri të procedurës penale në Kosovë, 26 Qershor 2016 (Raporti i OSBE-së).

17. Në sistemin e drejtësisë në Kosovë në lidhje me mbrojtjen në procedurë penale përcaktohet sistemi i mbrojtjes së detyruar dhe sistemi e mbrojtjes jo të detyruar (fakultative). Problemi kryesor që paraqitet në praktikën e gjykatave në Kosovë ka të bëjë me caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar sipas ligjit, pra është fakultative (që përbën edhe fokusin kryesor të analizës në ketë raport).
18. Caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar rregullohet në nenin 58 të KPP, ku në *parag. 1 (nënparg. 1.1 dhe 1.2)*, përcaktohet se kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse: *nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënim i burgim me tetë (8) ose më shumë vjet, ose këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënim i parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.*
19. Avokati i Popullit, thekson nevojën e interpretimit afirmativ të rasteve kur caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike “*e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënim i parashikuar...*”, ku aktualisht në praktikën e gjykatave penale të pandehurit nuk janë të përfaqësuar me avokat mbrojtës. Këto konkluzione dalin edhe nga hulumtimet dhe raportet që ju referuam me lartë.
20. KPP nuk ka një përkufizim ose kritere të veçanta në lidhje me interpretimin e se kur ekziston “*interesi i drejtësisë*” për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike. Andaj në lidhje me sqarimin e këtij kriteri, Avokati i Popullit do të bazohet në interpretimin e dispozitave tjera ligjore në lidhje me të drejtën e caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike, përcaktimet e akteve ndërkombëtare dhe në veçanti standardin e ndërtuar nga jurisprudanca e GJEDNJ, si burim detyrues dhe me prioritet për sistemin e drejtësisë penale në Kosovë.

A. Standardet ndërkombëtare – praktika e GJEDNJ

21. Avokati i Popullit, rikujton se detyrimi i institucioneve të drejtësisë së Kosovës për të zbatuar standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut buron nga Kushtetuta, përkatësisht neni 22 i saj, ku listohen disa nga aktet themelore për të drejtat e njeriut të cilat “*zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike...*” . Ky parim vlen edhe në lidhje me të drejtën për të pasur avokat mbrojtës në procedurë penale, përfshirë edhe caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike. Me qëllim të argumentimit të kësaj të drejte themelore, Avokati i Popullit në vijim do të analizoj dispozitat e këtyre akteve, me fokus interpretimet e dhëna në vendimet e GJEDNJ.
22. Kështu në pajtim me nenen 22 të Kushtetutës, në rend të parë, e drejta për të pasur mbrojtës shprehet parimisht edhe në dispozitat e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: DUDNJ), ku në nenen 11 *parag.1* të saj, përcaktohet se: “*Secili që akuzohet për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm derisa*

në bazë të ligjit të vërtetohet fajësia në një proces publik në të cilin i sigurohen të gjitha garancitë e nevojshme për mbrojtjen e tij". Nga del se jetësimi i prezumimit të pafajësisë si parim themelor i procedurës penale ndërlidhet me garancitë që i pandehuri duhet të ketë për mbrojtje nga akuzat.

23. E drejta e të pandehurit për mbrojtje efektive përcaktohet edhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejmë: PNDCP), ku në nenin 14, *parag.3*, ndër të tjera parashihet se secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë plotësishët të barabartë, të ketë këto garanci minimale: (a) *Të informohet menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme, në një gjuhë të cilën ai e kupton, lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzës që ngrihet kundër tij*; (b) *Të ketë kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tij;..."; (c) *Të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtje, duhet të informohet për të drejtën e tij që të ketë një të tillë dhe, kurdoherë që e kërkon interesë i drejtësisë, atij duhet t'i caktohet një mbrojtje falas në cilindorast të tillë nëse ai nuk ka mjete për të paguar*. Nga kjo vërehet se edhe në dispozitat e PNDCP shprehet e drejta e të pandehurit që në rastet kur nuk mund të paguaj vetë avokatin mbrojtës, ai të caktohet me shpenzime publike (falas) kur këtë e kërkon "interesi i drejtësisë" (si kriter i përcaktuar edhe në KPP).*
24. Në lidhje me nenin 14 *parag.3* të PNDCP, kanë rëndësi të veçantë edhe sqarimet e dhëna nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut pranë OKB-së (HRC) në Komentin e përgjithshëm Nr.32 mbi "të drejtën e barazisë para gjykatës dhe gjykimin e drejtë" të datës 23 gusht 2007.³ Në ketë koment, që në fillim theksohet se e drejta për barazi para gjykatave dhe për gjykim të drejtë është një element kyç i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe shërben si një mjet procedural për të mbrojtur sundimin e ligjit(*parag.2*), duke sqaruar se varësishët nga ndihma juridike (mbrojtja) ose mungesa e saj përcaktohet se sa kuptimplotë është pjesëmarrja e një personi në procedurë (*parag.10*). Ndërsa në lidhje me "interesin e drejtësisë" sqarohet se ky kriter vlerësohet në bazë të peshës së veprës penale, dhe në varësi të shanseve për suksesin e çështjes, që të vendoset nëse mbrojtësi duhet të caktohet nga ana e gjykatës. Gjithashtu në kuptim të kësaj të drejte, theksohet se avokati duhet të ketë rol efektiv në interes të personit të pandehur (*parag.38*).
25. Me theks të veçantë, Avokati i Popullit sqaron se në lidhje me standardin e barazisë së armëve në procedurë penale, rëndësinë e mbrojtjes efektive, si dhe kriteret për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë, ka rëndësi fondamentale zbatimi i KEDNJ dhe standardeve të ndërtuara nga GJEDNJ.
26. Kështu, në nenin 6, *parag.3* të KEDNJ përcaktohet se çdo i pandehur ka të paktën të drejtë që: a. *të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që bëhet kundër tij*; b. *t'i jepen koha dhe lehtësitet e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes*; c. *të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se nuk ka*

³ Me shumë mbi Komentin Nr.32 të HRC shih <http://www.refworld.org/docid/478b2b2f2.html> [17 072017].

mjete për të shpërblir një mbrojtës, të mund të ndihmohet falas nga një avokat i caktuar zyrtarisht, kur e kërkojnë interesat e drejtësisë;

Në ketë dispozitë, KEDNJ përcakton të drejtën në mbrojtje dhe në veçanti kur është e nevojshme edhe dhënien e ndihmës juridike falas (*pika c*) që lidhet kryesisht me konceptin e barazisë së armëve dhe respektimin e këtij parimi. Parimit të barazisë së armëve i ka dhënë rëndësi të posaçme GJEDNJ në praktikën e saj, duke e theksuar qartësisht se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabartë që të paraqesë çështjen e vet dhe se asnje palë nuk duhet të gjëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit.⁴ Për me tepër, gjykata për çështjet penale parimin e barazisë së armëve e ka lidhur ngushtë me lehtësirat e barabarta që mbrojtja duhet të ketë në raport me prokurorin e shtetit, duke i mundësuar shfrytëzimin e të gjitha mjeteve ligjore pa asnje pengesë ose vonesë të paarsyeshme,⁵ duke përfshirë edhe mos kufizimin e qasjes në faktet dhe provat që lidhen me rastin e tij apo edhe mundësinë e qasjes në dokumente publike.⁶ Gjithashtu, parimi i barazisë së armëve duhet të shprehët edhe me dëshmitarët apo ekspertët, që pavarësisht nga cila palë propozohen, ata duhet të gjëzojnë të njëjtat lehtësira para gjykatës, në të kundërtën, kjo paraqet shkelje të nenit 6 të KEDNJ.⁷

27. Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, ka rëndësi të veçantë përcaktimi i nenit 6, *parag.3 (c)*, që siç u citua me lartë, siguron të drejtën që i pandehuri të mbrohet vetë ose me ndihmën e avokatit mbrojtës, dhe në rastet kur nuk ka mundësi të paguaj avokatin, kjo ti mundësohet pa pagesë kur ketë e kërkojnë interesat e drejtësisë.
28. Në lidhje me të drejtën e angazhimit të avokatit mbrojtës, në pajtim me dispozitën e lartpërmendur, GJEDNJ ka vendosur si standard themelor se kjo e drejtë nuk mund të jetë diçka thjesht formale procedurale, por angazhimi i avokatit (me shpenzime publike) duhet të jetë efektiv në përfaqësimin e të pandehurit në procedurë. Kështu, në raport me ketë standard, Gjykata në rastin *Artico kundër Italise* është shprehur se edhe pse autoritet nuk mund të jenë përgjegjëse për çdo gabim të avokatit në lidhje me ushtrimin e funksioneve të mbrojtjes së të pandehurit, duhet theksuar se neni 6 *parag.3 (c)* flet për “**asistencë**” (*ndihmë*) dhe jo për “**emërim**”. Andaj, në të gjitha rastet kur autoritet kuptojnë se avokati i shmanget detyrimeve të mbrojtjes dhe nuk ofron mbrojtje efektive, duhet ta zëvendësojnë atë ose ta detyrojnë që të përbushë detyrimet e tij.⁸
29. Nga ky standard i shprehur nga GJEDNJ, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se edhe për gjykatat penale në Kosovë, lind detyrimi për tu kujdesur që i pandehuri jo vetëm të ketë të caktuar një avokat mbrojtës, por edhe që detyrimet e tij ti ushtoj në mënyre efektive. Pra, bëhet fjalë për standardin e një roli aktiv të gjykatës për tu kujdesur që i pandehuri ka përfaqësim adekuat në procedurë penale. Sigurisht, ndërhyrja e gjykatës për ketë

⁴ *De Haes dhe Gijssels kundër Belgikës*, 24 Shkurt 1997.

⁵ *Shih Borgers kundër Belgikës*, 30 Totor 1991; *Kuopila kundër Finlandës*, 27 Prill 2000; *Makhfi kundër Francës*, 19 Totor 2004; *Zhuk kundër Ukrainës*, 21 Totor 2010.

⁶ *Shih Matyjek kundër Polonisë*, 24 Prill 2007.

⁷ *Bönisch kundër Austrisë*, 6 Maj 1985.

⁸ *Artico kundër Italise*, 30 Prill 1980.

qëllim (*në pajtim me nenin 6, parag.3 (c)*) kërkohet vetëm në rastet kur qartësisht vërehet se avokati ka dështuar të siguroj përfaqësim efektiv për të pandehurin.⁹

30. Për më tepër, duke shprehur rëndësinë që ka mbrojtja efektive për garantimin e të drejtave për të pandehurin, respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe gjykimin e drejtë, GJEDNJ është shprehur se në rastet kur është e qartë se avokati që përfaqëson të pandehurin nuk ka pasur kohën e mjaftueshme në dispozicion apo nuk ka pasur lehtësirat e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes, gjyqtari që drejton procedurën ka detyrimin që të marrë masa të natyrës pozitive për të siguruar që detyrimet e avokatit ndaj të pandehurit do të përbushen. Zakonisht, në raste të kësaj natyre mund të kërkohet një shtyrje e seancës.¹⁰
31. Në anën tjeter, gjykata ka sqaruar edhe një aspekt të veçantë në lidhje me caktimin e avokatit mbrojtës pa pagesë, e që ka të bëjë edhe me të drejtën e zgjedhjes së avokatit nga i pandehuri. Gjykata është shprehur se e drejta për të zgjedhur avokatin, ekziston vetëm kur i pandehuri ka mjete të mjaftueshme për të paguar avokat, ndërsa kur avokati caktohet nga shteti, i pandehuri nuk ka të drejtë të zgjedhë përfaqësuesin e tij, dhe nuk mund të konsultohet për ketë aspekt.¹¹
32. Gjithashtu, gjykata ka konstatuar se mospjesëmarrja e avokatit të të pandehurit që është thirrur me rregull (*një strategji që edhe mund ta përdorin avokatët për të zvarritur procedurën!*) dhe mos pranimi i avokatit të caktuar nga gjykata nga ana e të pandehurit, nuk përbën shkelje të nenin 6, *parag.3 (c)* nëse procedura penale është zhvilluar pa prezencën e avokatit. Ky standard është sqaruar në vendimin e GJEDNJ në çështjen “*Balliu kundër Shqipërisë*”, ku gjykata ka konstatuar se nuk ka shkelje të kësaj dispozite nga gjykatat në Shqipëri në lidhje me zhvillimin dhe përfundimin e procedurës penale ndaj z. Balliu pa prezencën e avokatit, ku ai ishte dënuar me burgim të përjetshëm për pesë vrasje, dy vrasje në tentativë, një vepër penale për mbajtje të municionit luftarak dhe veprën penale të krijimit dhe pjesëmarrjes në bandë të armatosur... . Ketë vendim, GJEDNJ e kishte bazuar në faktin se derisa avokati i z. Balliu ka munguar në shumicën e seancave duke mos dhënë asnjë arsyetim, gjykata shqiptare kishte kryer detyrimet e saj (që burojnë nga neni 6, *parag.3 (c)* i KEDNJ) derisa i kishte caktuar avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare, të cilin i pandehuri, z. Balliu nuk e ka pranuar.¹² Pra, edhe në ketë rast është konfirmuar standardi se i pandehuri nuk mund të zgjedhë avokatin i cili caktohet nga shteti, me shpenzime publike, dhe kjo është nuk mund të përdoret as për zvarritje eventuale të procedurës penale.
33. Gjykata ka trajtuar edhe kriteret për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, ku edhe sipas KEDNJ bazohet në dy kritere apo rrethana: ***mungesa e mjeteve të mjaftueshme për të paguar avokatin*** dhe ***interesat e drejtësisë***. Në lidhje me mungesën e mjeteve për të paguar avokatin, GJEDNJ ka theksuar se niveli i provave të kërkua nga i pandehuri për të vërtetuar se ai nuk disponon mjetet e mjaftueshme për mbrojtje, nuk

⁹ *Kamasinski kundër Austrisë*, 19 Dhjetor 1989.

¹⁰ *Goddi kundër Italisë*, 9 Prill 1984.

¹¹ *M kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 24 Qershor 2008.

¹² *Balliu kundër Shqipërisë*, 16 Qershor 2005.

duhet të jetë shumë i lartë. Ndërsa në lidhje me kriterin e dytë, për të garantuar interesat e drejtësisë, gjykata ka theksuar disa kushte si: *aftësinë (përgatitjen) juridike të të pandehurit për të përfaqësuar çështjen e tij pa ndihmën e avokatit; serioziteti i veprës penale, kompleksiteti i çështjes dhe serioziteti i dënimit që mund të shqiptohet*. Në përgjithësi, është me rëndësi të theksohet se gjykata ka vënë në pah mungesën e kualifikimit të duhur juridik të personit të pandehur, si kusht për caktimin e avokatit mbrojtës.¹³ Pastaj, në mënyrë të posaçme, gjykata ka ndërtuar standardin se në të gjitha rastet “*kur është i mundshëm privimi i lirisë për të pandehurin, atëherë interesat e drejtësisë e kërkojnë që atij ti caktohet avokati mbrojtës*”.¹⁴

34. Në ketë drejtim, Avokati i Popullit thekson se një nga kriteret kryesore ku duhet të bazohet caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike ndaj të pandehurve në Kosovë, në kuptim të garantimit të interesave të drejtësisë duhet të jetë mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim efektiv. Si i tillë, ky kriter është edhe me lehtë të përcaktohet nga ana e gjykatave.
35. Për me tepër, ketë kriter GJEDNJ edhe në disa vendime tjera e ka përcaktuar si të detyrueshëm për shtetin që të caktoj avokat mbrojtës pa pagesë (me shpenzime publike) kur ndaj një të pandehur ekziston mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim.¹⁵
36. Një çështje tjeter që gjykata e ka theksuar në praktikën e saj, ka të bëjë me nevojën që në rastet kur është refuzuar kërkesa për caktimin e avokatit pa pagesë, ky vendim duhet të rishqyrtohet në fazat e caktuara të procedurës në varësi të kompleksitetit të çështjes.¹⁶ Mbi ketë bazë, edhe Avokati i Popullit insiston se ky standard duhet të zbatohet edhe për rastet që trajtohen në gjykatat e Kosovës.
37. Mbi bazën e këtyre argumenteve të paraqitura, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se në lidhje me vendosjen për caktimin e avokatit mbrojtës me shpenzime publike, edhe gjykatat në Kosovë duhet të bazohen në këto kritere dhe standarde që ka ndërtuar GJEDNJ, në mënyrë që të ketë zhvillim të procedurës penale në pajtim me vendimet e kësaj gjykate (si burim primar për institucionet e Republikës së Kosovës) dhe në zbatim të nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës.

B. Mbrojtja efektive në çështjet penale sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës – caktimi i avokatit mbrojtës me shpenzime publike

38. Siç u trajtua edhe me lartë, në bazë të Kushtetutës, e drejta për mbrojtje efektive në procedurë penale në Kosovë duhet të zbatohet në pajtim me standarde të larta ndërkombëtare, me theks të veçantë me ato kritere që përcakton KEDNJ dhe vendimet e GJEDNJ, të cilat kanë prioritet në raport me legjislacionin e brendshëm. Ky standard definohet në nenin 22 të Kushtetutës, ku përcaktohet se: “*Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare ... garantonë me këtë*

¹³ Shih në veçanti *Hoang kundër Francës*, 29 Gusht 1992; *Bulut kundër Austrisë*, 22 Shkurt 1996; *Foucher kundër Francës*, 18 Mars 1997; *Klimentyev kundër Rusisë*, 16 Nëntor 2006; etj.

¹⁴ *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 10 Qershori 1996.

¹⁵ *Quaranta kundër Zvicrës*, 24 Maj 1991.

¹⁶ *Granger kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 Mars 1990.

Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institacioneve publike... ”.

39. E drejta për mbrojtje, si e drejtë themelore për të pandehurin përcaktohet edhe në nenin 30 (Të drejtat e të akuzuarit), *parag.1* (*nënpag.2, 3 dhe 5*) të Kushtetutës, ku përveç tjerash parashihet se: “*Çdokush që akuzohet për vepër penale, gjëzon të drejtat minimale në vijim: (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit; (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas.*
40. Pastaj edhe në nenin 31 ku përcaktohet “E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm”, parashihet se: *1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. ...; 4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet. ...; 6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.*
41. Nga këto dispozita të lartpërmendura, del se Kushtetuta qartësishët e definon të drejtën për mbrojtje si një e drejtë efektive në procedurë penale, që mund të ushtrohet përmes mbrojtësit, dhe në rastet kur i pandehuri nuk ka mjete të mjaftueshme financiare, ndihma juridike të ofrohet falas, si parakusht i qasjes efektive në drejtësi.
42. Përveç këtyre garancive kushtetuese, Avokati i Popullit rikujton se në lidhje me të drejtën për mbrojtje efektive ka një standard edhe me të avancuar, derisa është detyrueshme që këto dispozita të interpretohen në pajtim me vendimet e GJEDNJ, siç përcaktohet në nenin 53 të Kushtetutës se: “*Të drejtat njeriut dhe liritet themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”. Si i tillë, ky përcaktim obligon që gjykatat në Kosovë të kujdesen që për të gjitha rastet penale kur i pandehuri nuk ka mjete financiare të mjaftueshme, të caktojnë avokat mbrojtës falas (sipas standardeve që ka ndërtuar GJEDNJ, të cilat janë trajtuar edhe në ketë raport).
43. Përveç përcaktimit në Kushtetutë, e drejta e të pandehurit për të pasur mbrojtës, duke përfshirë edhe të drejtën për angazhimin e tij me shpenzime publike, rregullohet në mënyrë me të plotë në kuadër të dispozitave të KPP.
44. Avokati i Popullit, gjithashtu, rikujton se KPP që në dispozitat e tij parimore i kushton një vëmendje të posaçme barazisë së armëve ndërmjet të pandehurit dhe prokurorit të shtetit, si palë në procedurë penale. Kështu, në nenin 9 të KPP si parim themelor i procedurës penale përcaktohet “**barazia e palëve**”, ku në *parag.1* parashihet se: “*Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.*” Në zbatim të këtij parimi, siç është sqaruar edhe me lartë në ketë raport, barazia e palëve në kuptim të plotë të saj, mund të shprehët vetëm nëse kemi

barazi nga aspekti profesional, standard që për të pandehurin mund ta siguroj angazhimi i avokatit mbrojtës.

45. Pastaj, duke u bazuar edhe në faktin se sipas KPP që është në fuqi nga 1 janar 2013, zbatohet modeli me premisa të tipit akuzator për dallim nga kodi i kaluar¹⁷, caktimi i avokatit mbrojtës dhe përgatitja efektive e mbrojtjes marrin vlerë të posaçme për shkak të rolit që tani kanë palët në procedurë penale. Në këtë drejtim, detyrimi i gjykatave penale është edhe shumë më i madh që të kujdesen për garantimin e të drejtës për mbrojtje efektive për të pandehurin. Edhe për këtë arsy, mohimin e të drejtës për caktim të mbrojtësit me shpenzime publike (për rastet kur i pandehuri nuk ka mjete financiare dhe e kërkojnë interesat e drejtësisë), siç aktualisht ndodh në shumicën e rasteve në gjykatat e monitoruara, Avokati i Popullit e konsideron veprim në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe kushtetuese që kanë gjykatat.
46. Për me tepër, edhe në dispozitat e tjera të KPP, mbrojtja e të pandehurit afirmohet si e drejtë themelore në procedurë penale. Ky orientim shprehet në mënyrë të vazhdueshme në KPP dhe në lidhje me shumë të drejta të tjera procedurale që garantohen për të pandehurin. Si e tillë, e drejta për të pasur avokat mbrojtës (duke përfshirë edhe rastet kur është e nevojshme të caktohet falas, me shpenzime publike) nuk mund të shmanget nga gjykatat penale në Kosovë. Aq me tepër, kur ky obligim për gjykatat penale del edhe nga KEDNJ dhe vendimet e GJEDNJ.
47. Kështu, Avokati i Popullit vlerëson se edhe dispozitat aktuale të KPP e drejta për të pasur avokat mbrojtës, dhe e drejta e caktimit të avokatit me shpenzime publike, është e drejtë që ka karakter obligator dhe si e tillë duhet të zbatohet nga gjykatat në Kosovë.
48. KPP në nenin 11 në lidhje me standardin e përshtatshmërisë së mbrojtjes, përcakton se: “1. *I pandehuri ka të drejtë në kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij.* 2. *I pandehuri ka të drejtë të mbrohet personalisht ose me ndihmën e mbrojtësit i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës, sipas zgjedhjes së tij.* 3. *Në qoftë se i pandehuri nuk angazhon mbrojtës për të siguruar mbrojtjen, kurse mbrojtja është e detyrueshme, të pandehurit i caktohet mbrojtës i pavarur me përvojë dhe me kompetencë në përputhje me llojin e veprës penale dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod.* 4. *Sipas kushteve të parapara me këtë Kod, të pandehurit i cili nuk mund t'i paguajë shpenzimet e mbrojtjes dhe për këtë arsy nuk mund të angazhojë mbrojtës, me kërkesë të tij i caktohet një mbrojtës i pavarur me përvojë dhe me kompetencë konform me llojin e veprës penale, që paguhet nga mjetet e buxhetit kur interesat e drejtësisë këtë e kërkojnë.* 5. *Gjykata ose organi kompetent i cili e drejton procedurën penale detyrohet ta njoftojë të pandehurin për të drejtën e tij në mbrojtës që nga marrja në pyetje për herë të pare, ashtu siç parashihet me këtë Kod”.*

¹⁷ Siç dihet, deri në hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale (1 janar 2013) në sistemin tonë zbatohej sistemi inkuizitor, ku gjyqtari kishte rol aktiv në mbledhjen e provave dhe përgjegjësi funksionale me të madhe për mbrojtjen e të drejtave të personit të pandehur në procedurë penale. Me Kodin e ri është akceptuar modeli i sistemit akuzator kur gjyqtari tani nuk e ka këtë rol, por barra bie mbi prokurorin e shtetit dhe të pandehurin për mbledhjen dhe prezantimin e provave, prandaj edhe detyrimet dhe përgjegjësitë e mbrojtjes në procedurë janë

49. Nga këto dispozita del se e drejta për mbrojtje duhet të garantohet gjerësisht në procedurë penale (edhe për rastet kur i pandehuri nuk mund t'i paguaj shpenzimet e mbrojtjes), duke i dhënë të pandehurit edhe kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes efektive (që përkon edhe me standardin e shprehur nga vendimet e GJEDNJ, siç është cituar edhe në ketë raport). I takon gjykatës që edhe për këto të drejta ta njoftoj të pandehurin, siç parashihet edhe në nenin 16 të KPP, se: “*Gjykata detyrohet të njoftojë të pandehurin ... për të drejtat që i përkasin sipas këtij Kodi, si dhe për pasojat e mosveprimit të tij nëse ai, për shkak të mosdijes, nuk ndërmerr veprimin e duhur në procedurë ose i nuk shfrytëzon të drejtat e tij.*”
50. E drejta e të pandehurit për të pasur mbrojtës përcaktohet me konkretisht në nenin 53 të KPP, ku parashihet se i pandehuri ka të drejtë të ketë mbrojtës në të gjitha fazat e procedurës penale, dhe është obligim i organeve kompetente (policisë, prokurorisë dhe gjykatës) që të njoftojnë të pandehurin për ketë të drejtë (shih *parag.1* dhe *2*). Në kuadër të këtij nenit parashihen edhe kushtet se kur i pandehuri mund të heqë dorë nga e drejta për të pasur mbrojtës, dhe në cilat raste heqja dorë nuk është e mundur (*parag.3-8*). Gjithashtu, KPP përmban dispozita edhe në lidhje me kualifikimet që duhet të ketë avokati mbrojtës (neni 54), kufizimet që avokati i ka në raport me përfaqësimin në procedurë penale (neni 55) dhe rastet kur mbrojtësi përjashtohet (neni 56).
51. Duhet theksuar se KPP përcakton dy lloje të mbrojtjes: ***mbrojtjen e detyruar*** (*rastet kur edhe nëse i pandehuri nuk angazhon mbrojtës, është e obligueshme caktimi i mbrojtësit bëhet sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike*) dhe ***fakultative*** (*rastet kur mbrojtësi mund të caktohet me shpenzime publike pas vlerësimit të kushteve të caktuara*).
52. Rastet kur mbrojtja është e detyruar përcaktohen në nenin 57 të KPP, ku në *parag.1* (*nënpag.1.1-1.5*) parashihet se i pandehuri duhet të ketë mbrojtës:
- *nga marrja në pyetje për herë të parë kur i pandehuri është memec, shurdh, i verbër ose shpreh shenja të çrregullimeve apo paftësisë mendore dhe kështu është i paftë që të mbrohet vetë me sukses;*
 - *gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim;*
 - *nga ngritja e aktakuza, kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim;*
 - *në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, shurdh ose shpreh shenja të çrregullimit apo të paftësisë mendore ose është shqiptuar dënim me burgim të përjetshëm;*
 - *dhe në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyjë në marrëveshje për pranimin e fajësisë për vepër penale për të cilën parashihet dënim me së paku një (1) vit burgim, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi.*

shumë me të mëdha. Me shumë shih edhe Udhëzuesi i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë 2013 (tutje Udhëzuesi i KPP) fq.31 dhe vazhdim.; Raporti i OSBE-së, fq.8-20.

Për të gjitha këto raste (të mbrojtjes së detyruar), nëse i pandehuri nuk angazhon mbrojtës dhe ketë nuk e bëjnë as personat e afërm siç përcaktohet me ligj, atëherë gjykata (ose organi tjetër kompetent) është e obliguar të caktoj mbrojtësin sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike (*parag.2*).

53. Për dallim nga rastet e lartpërmendura kur mbrojtja është e detyruar, sfida kryesore për praktikën gjyqësore në Kosovë mbetet caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike për rastet kur sipas KPP mbrojtja nuk është e detyruar (dhe caktimi i mbrojtësit mund të bëhet pas kërkesës së personit të pandehur dhe nën kushtet e caktuara që i vlerëson gjykata).
54. Neni 58 i KPP parasheh caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar. Kështu në *parag.1 (nënparag.1.1-1.2)* parashihet se kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse:
- *nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burgim me tetë (8) ose më shumë vjet, ose*
 - *këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënim parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.*
55. Nga këto dispozita del se KPP ka përcaktuar dy raste apo situata kur mbrojtja nuk është e detyruar, dhe mund të caktohet mbrojtësi me shpenzime publike sipas kërkesës së të pandehurit.
56. Në rastin e parë, kur “*procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burgim me tetë (8) ose më shumë vjet*”, Avokati i Popullit vlerëson se është i përcaktuar një kufi shumë i lartë në lidhje me dënimin me burgim prej “*tetë (8) ose më shumë vjet*”, sepse duke ju referuar Kodit Penal të Kosovës, ky kriter gjen zbatim për një numër të kufizuar të veprave penale, që janë shumë të rënda, për të cilat do të arsyetohej mbrojtja e detyrueshme.
57. Avokati i Popullit, rikujton se problemi kryesor në praktikën e gjykatave në Kosovë, ka të bëjë me rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike mund të bëhet kur “*këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënim parashikuar, të dyshuarit apo të pandehurit me kërkesën e tij i caktohet mbrojtësi, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes së tij.*
58. Duke u bazuar nga të dhënat e hulumtimeve dhe monitorimi i seancave gjyqësore, del se në shumicën e rasteve penale, gjykatat nuk caktojnë avokat mbrojtës me shpenzime publike për rastet e tillë (*kur e kërkojnë interesat e drejtësisë dhe i pandehuri nuk mund t'i mbuloj shpenzimet e mbrojtjes*), dhe procedura penale ndaj të pandehurit përfundon pa pasur avokat mbrojtës. Kjo praktikë përbën shkelje të standardeve ndërkombëtare, në rend të parë, neni 6 *parag.3 (c)* të KEDNJ dhe vendimeve të GJEDNJ në lidhje me të.

59. Për me tepër, siç është analizuar edhe në ketë raport, GJEDNJ ka sqaruar shumë aspekte në lidhje caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike (ndihma juridike pa pagesë), sidomos në lidhje me atë që konsiderohet “*interes i drejtësisë*” dhe standardin e vlerësimit të gjendjes financiare, andaj, kjo praktikë e konsoliduar nga GJEDNJ, duhet të zbatohet edhe nga gjykatat në Kosovë.
60. Në nenin 58 parashihet edhe detyrimi i gjykatës (ose organit tjetër kompetent) që të njoftoj të pandehurin për të drejtën e tij që të kërkoj caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, para se të merret në pyetje për herë të parë (*parag.2*). Ndërsa sa i përket kohës së paraqitjes së kërkesës për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, KPP përcakton një zgjidhje të drejtë dhe affirmative, duke i dhënë mundësinë të pandehurit që kërkesën ta bëj pa kufizim gjatë gjithë procedurës penale (*parag.3*). Para caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike, i pandehuri duhet të plotësojë një deklaratë duke cekur pasuritë e tij dhe të deklarohet se nuk mund të përballojë shpenzimet e mbrojtësit ligjor (*parag.4*).
61. Duke rikujtuar standardin e GJEDNJ, se në rastet kur mund të shqiptohet dënim i me burgim duhet të caktohet mbrojtësi pa pagesë (shih çështjet *Quaranta kundër Zvicrës dhe Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, që janë trajtuar edhe në ketë raport), Avokati i Popullit insiston se edhe gjykatat në Kosovë duhet të caktojnë mbrojtës me shpenzime publike në të gjitha rastet kur për atë vepër penale parashihet dënim i me burgim. Ketë konstatim, Avokati i Popullit e mbështet në detyrimin kushtetues që kanë gjykata që dispozitat mbi të drejtat e njeriut ti zbatojnë në harmoni me vendimet e GJEDNJ (neni 53 i Kushtetutës).
62. Në bazë të trajtimeve paraprake mbi standardet ndërkombëtare dhe analiza e dispozitave të legjislacionit të Kosovës, Avokati i Popullit konstaton se e drejta për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike është e detyrueshme për gjykatat dhe ka karakter absolut. Aq me tepër, ketë standard e mbështetë gjërësisht jurisprudanca e GJEDNJ.
63. Andaj, praktika e deritashme e gjykatave duhet të ndryshohet, dhe në harmoni me këto standarde të obligueshme, të caktohet mbrojtësi me shpenzime publike edhe për rastet nga nenin 58, *parag.1, nënpagrag.1.2* i KPP, dhe pa asnjë përashtim kur parashihet mundësia e shqiptimit të dënit të me burgim.
64. Gjithashtu, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se e drejta për të pasur mbrojtës, duke përfshirë edhe të drejtën e caktimit e tij me shpenzime publike, nuk mund të trajtohet vetëm si një e drejtë në vetvete, por e lidhur edhe me të drejtat e tjera procedurale që parashihen për të pandehurin, si: e drejta për të kundërshtuar provat, kundërshtimi i aktakuzës, propozimi dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe ekspertëve, shfrytëzimi i mjeteve juridike, etj. Ky për shfrytëzim efikas të këtyre të drejtave, dhe zbatim të parimit të barazisë së palëve në procedurë penale, është parakusht angazhimi i avokatit mbrojtës për të pandehurin.

Konstatimet kryesore të Avokatit të Popullit

65. E drejta për të pasur avokat mbrojtës është një nga të drejtat themelore për të pandehurin, dhe shprehje e parimit të barazisë së armëve me prokurorin e shtetit në

procedurë penale (barazisë nga aspekti i njohurive juridike). Si e tillë, e drejta për të pasur avokat mbrojtës është pjesë integrale e gjykimit të drejtë.

66. Kjo e drejtë si parakusht për gjykim të drejtë për të pandehurin, përcaktohet me Kushtetutë, dispozitat e KPP dhe aktet ndërkombe të përdrejtë në Kosovë (dhe për me tepër kanë prioritet në raport me ligjet dhe aktet e tjera të brendshme). Gjithashtu, standardi i zbatimit të kësaj të drejte është svaruar edhe nga një numër i konsiderueshëm i vendimeve të GJEDNJ.
67. Aspekt i veçantë i të drejtës për të pasur mbrojtës, përbën e drejta e caktimit të avokatit mbrojtës me shpenzime publike, në rastet kur i pandehuri nuk ka mundësi financiare dhe ketë e kërkijnë interesat e drejtësisë.
68. Derisa KPP përveç rasteve kur mbrojtja është e detyruar (në rastet kur i pandehuri nuk angazhon avokat mbrojtës, ai caktohet sipas detyrës zyrtare), përcaktohet edhe mundësia e caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike kur mbrojtja nuk është e detyruar. Kjo e fundit, sipas KPP është lënë në diskrecion të gjykatës, që pas kërkësës se personit të pandehur dhe deklaratës se nuk ka mundësi financiare të paguaj shpenzimet e mbrojtjes, të vlerësohet nëse ketë e kërkijnë interesat e drejtësisë.
69. Avokati i Popullit, në lidhje me objektin kryesor të trajtimit në ketë raport, dhe duke u bazuar nga të gjeturat e monitorimit të praktikës së gjykatave penale në Kosovë, konstaton se:
 - Gjykatat në Kosovë në shumicën absolute të rasteve penale, ku sipas KPP mbrojtja nuk është e detyruar, nuk kanë caktuar mbrojtës me shpenzime publike. Madje, edhe në rastet kur është shqiptuar dënim i me burgim, të pandehurit janë gjykuar pa avokat mbrojtës.
 - Kjo praktikë, parqet shkelje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese që kanë gjykatat në lidhje me garantimin e të drejtës për mbrojtje efektive për të pandehurin në procedurë penale. Si e tillë, kjo praktikë e gjykatave paraqet shkelje të parimit të barazisë së armëve në procedurë penale.
 - Për me tepër, kjo përbën shkelje të obligimeve që dalin nga aktet ndërkombe të, si PNDCH, KEDNJ dhe me vendimet e GJEDNJ në lidhje me të drejtën që i pandehuri të ketë mbrojtje juridike falas.
 - Gjithashtu, kjo është tregues se sistemi i drejtësisë penale në Kosovë nuk zbaton dhe nuk është i familjarizuar me standartet ndërkombe të, në veçanti praktikën e GJEDNJ.
70. Si përfundim, Avokati i Popullit e konsideron të domosdoshme që këto praktika të mos përsëriten në të ardhmen, në mënyrë që vendimet e organeve të drejtësisë penale, në lidhje me caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike (në rastin kur mbrojtësi nuk caktohet sipas detyrës zyrtare) të jenë në pajtim me detyrimet kushtetuese, ligjore dhe standartet ndërkombe që janë të obligueshme (me theks KEDNJ dhe vendimet e GJEDNJ).

Rekomandimet e Avokatit të Popullit

Në bazë të analizës në ketë raport dhe konstatimeve të arritura, në pajtim me nenin 135, parag.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 16, parag.4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit rekomandon për:

- **Ministrinë e Drejtësisë/Departamentin Ligjor:**
 - që në kuadër të reformës për ndryshim/plotësim të KPP të përcaktohet në mënyrë me të qartë e drejta për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, që kjo e drejtë të jetë e obligueshme dhe në pajtim me praktikën e ndërtuar nga GJEDNJ.

Gjykatën Supreme të Kosovës, që në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore:

- të nxjerrë mendim juridik për të udhëzuar gjykatat e shkallës me të ultë që të zbatojnë vendimet e GJEDNJ, edhe në lidhje me caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike, dhe mbi standardet e kësaj gjykate të respektohet edhe parimi i barazisë së palëve në procedurë penale.

Këshillin Gjyqësor të Kosovës:

- që të udhëzoj të gjitha gjykatat, në mënyrë që gjyqtarët në çështjet penale të kenë kujdes të shtuar për respektim rigoroz të të drejtës së të pandehurit për të pasur mbrojtës, në veçanti për të drejtën që mbrojtësi të caktohet me shpenzime publike. Në ketë qëllim si referencë kryesore të jetë praktika e GJEDNJ.
- të kujdeset për të propozuar një buxhet me të lartë në lidhje me mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes, për rastet kur mbrojtësi duhet të caktohet me shpenzime publike.

Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Kryeprokurorin e Shtetit: që në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të ndërmarrim masat e nevojshme:

- që të udhëzojnë dhe mbikëqyrin respektimin e të drejtës së personave të pandehur për t'u informuar në kohë mbi të drejtën për të pasur mbrojtës, në veçanti për të drejtën e caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike.
- Që e drejta e mbrojtjes dhe parimi i barazisë së armëve në procedurë penale (me theks në fazën e hetimit dhe ngritjes së aktakuzës) të respektohet në mënyrë rigoroze dhe në pajtim me standardet me të larta profesionale.

Akademinë e Drejtësisë/Këshillin Programor:

- që në kuadër të programit të tyre të ofrojnë trajnime shtesë të fokusuara mbi të drejtën e personit të pandehur për të pasur avokat mbrojtës, në veçanti për të drejtën e caktimit të mbrojtësit me shpenzime publike. Që trajnimet për ketë qëllim të kenë si referencë kryesore praktikën e GJEDNJ.

Në pajtim me nenin 132, parag.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i

detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj.”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), mirësish Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

